

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri


Mars 2021

Tiranë, më 23 Prill 2021: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Mars 2021, janë 394.478. Krahasuar me Mars 2020, ky tregues rezultoi me rritje 44,8 %. Në Mars 2021, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 170.279. Krahasuar me Mars 2020, ky numër është rritur me 78,6 %. Ndryshimet në përqindje të treguesve të lëvizjes së shtetasve, janë ndikuar nga masat e pandemisë të vendosura në muajin Mars 2020.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë tremujorit të parë të 2021 është 513.781, duke rënë me 10,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020 (tab.1).

Gjatë tremujorit të parë të 2021, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Kosova ka pasur rritjen më të madhe me 38,3 % dhe Zvicra me 32,7 %, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Greqia me 83,5 % dhe Anglia me 70,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 (tab.2).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Mars 2021, janë 413.443 duke shënuar një rritje me 45,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Mars 2021, janë 255.768. Krahasuar me Mars 2020, ky numër është rritur me 45,6 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Mars 2021, janë 157.675. Krahasuar me Mars 2020, ky numër është rritur me 44,3 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë tremujorit të parë të 2021, është 756.405 duke rënë me 31,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Mars 2020	Mars 2021	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Mars 2020	Janar-Mars 2021	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje gjithsej	272.514	394.478	44,8	1.582.966	1.160.801	-26,7
Shqiptarë	177.193	224.199	26,5	1.009.243	647.020	-35,9
Të Huaj	95.321	170.279	78,6	573.723	513.781	-10,4
Dalje gjithsej	284.929	413.443	45,1	1.767.352	1.235.731	-30,1
Shqiptarë	175.627	255.768	45,6	1.100.290	756.405	-31,3
Të Huaj	109.302	157.675	44,3	667.062	479.326	-28,1

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Mars 2020	Mars 2021	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Mars 2020	Janar-Mars 2021	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	29.174	82.493	182,8	177.454	245.367	38,3
Maqedoni	15.442	31.198	102,0	87.706	93.179	6,2
Greqi	11.628	4.858	-58,2	88.477	14.600	-83,5
Itali	4.793	10.824	125,8	44.269	30.596	-30,9
Angli	2.831	1.336	-52,8	14.491	4.282	-70,5
Mali i zi	12.150	18.094	48,9	70.377	62.994	-10,5
Poloni	260	313	20,4	1.337	802	-40,0
SHBA	1.369	2.008	46,7	8.646	5.765	-33,3
Spanjë	156	192	23,1	1.120	515	-54,0
Gjermani	4.890	2.598	-46,9	11.188	7.158	-36,0
Zvicër	374	732	95,7	3.234	4.293	32,7
Të tjera	12.254	15.633	27,6	65.424	44.230	-32,4
Gjithsej	95.321	170.279	78,6	573.723	513.781	-10,4

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Mars 2020	Mars 2021	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Mars 2020	Janar-Mars 2021	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	95.321	170.279	78,6	573.723	513.781	-10,4
I. Personale	88.496	160.943	81,9	550.712	489.798	-11,1
1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor, etj.	83.522	153.944	84,3	525.908	466.709	-11,3
2. Qëllime fetare	17	17	0,0	90	85	-5,6
3. Udhëtarë transit	4.957	6.982	40,9	24.714	23.004	-6,9
II. Biznes dhe profesionale	6.825	9.336	36,8	23.011	23.983	4,2

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Mars 2020	38.304	10.956	223.254	38.323	8.514	238.092
Mars 2021	41.298	17.721	335.459	41.165	13.507	358.771
Ndryshimi vjetor (%)	7,8	61,7	50,3	7,4	58,6	50,7
Janar- Mars 2020	251.434	59.996	1.271.536	266.913	78.286	1.422.153
Janar- Mars 2021	113.484	49.751	997.566	126.931	53.194	1.055.606
Ndryshimi vjetor (%)	-54,9	-17,1	-21,5	-52,4	-32,1	-25,8

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj.;
2. Qëllime fetare;
3. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistrojnë shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarohen shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.